



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT GJYQËSOR PRIVAT
ZYRA PËRMBARIMORE « ANDANI BAILIFF OFFICE »

Adresa: Rr "S.Delvina", ND.51,H.9, K.P.1022, pranë H."DIPLOMAT" .Cel. 068 200 1313. e-mail rrokdeda@libero.it

Nr. **335** Prot

Tiranë më datë, 30.07.2018

Nr. 829 Rregj.

Lënda: Urdhër për vënien e sekuestros konservative në kuotat e debitorit

Baza ligjore: 527 e vijues të K.Pr.Civile

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

Tiranë

Për dijëni debitorit: Shoqëria "Micro Credit Albania" sh.a

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit Star", Tiranë

Unë **Rrok G. Deda**, përbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbareme "ANDANI BAILIFF OFFICE", pasi studiova materialet e çështjes përmbareme me Nr. **829**, bazuar në kërkesën e kreditorit Shoqëria "AFA-2010" sh.p.k dhe në Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 357 Dt. 30.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

KONSTATOVA:

Se në datë 19.07.2018 është depozituar pranë kësaj zyre kërkesa e kreditorit Shoqëria "AFA-2010" sh.p.k së bashku me Urdhërin Ekzekutimit të lëshuar për Titullin Ekzekutiv Vendim Nr. 1217 datë 06.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi me vendimin Nr. 10-2018-28/12 datë 15.01.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës, me palë dhe objekt:

-Kreditor: Shoqëria "AFA-2010" sh.p.k

-Debitor: Shoqëria "Micro Credit Albania" sh.a.

-Objekti: Shlyerje detyrimi

Në dispozitivin e vendimit të sipërcituar, Gjykata ka vendosur:

1. Rrezimin e padisë

2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Për palët në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit

Në kushtet kur për ekzekutimin e urdhërit të ekzekutimit duhet të kryhet bllokimi i kuotave apo kapitalit që ka ne pronesi debitori Shoqëria "Micro Credit Albania" Sh.a me NIPT: **L41729001H** si dhe ne zbatim te neneve 527 e vijues te k.Pr.Civile si dhe neneve të ligjit Nr.10 031 dt.11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbareme Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

I. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative në masën **100%** të kuotave e kapitalit të Shoqëria "Micro Credit Albania" Sh.a NIPT I **41729001H** me seli në

Bulevardi “Zogu I”, Rruga “Maliq Muço”, Qendra e Biznesit “Star”, Tiranë, me qëllim ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutiv Nr. 357 Dt. 30.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

II. Të na dërgohet kopje e ekstraktit historik me anë të së cilës të konfirmohet regjistrimi i masës së sekuestros.

III. Masa e bllokimit të vendoset deri në një urdhër të dytë të kësaj Zyre Përmbaremore.

IV. Për veprimet apo mosveprimet tuaja , na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

V. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

ZYRA PERMBARIMORE “ANDANI BAILIFF OFFICE”

PËRMBARUESI GJYQËSOR

RROK GULJELM DEDA

